



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:276251

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05476780

C.nr.1414/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit A.B nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti Rimbursim i dëmit, me vlerë të kontestit 4,130.00 euro, jashtë seance me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia për Rimbursimin e dëmit e datës 11.12.2023, e paditëses B... me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit A.B nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësja B... me seli në Prishtinë, rruga ..., me datë 11.12.2023, ka parashtruar padi për Rimbursimin e dëmit në shumën prej 4,130.00 euro, kundër të paditurit A.B nga fshati ..., Komuna e Gjilanit.

Me datë 20.12.2023, gjykata ia ka dërguar paditëses Vërejtjen që në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 40 euro.

Paditësja me datë 26.12.2023, e ka pranuar Vërejtjen për pagesën e taksës për padi, por edhe pas kalimit të afatit, nuk e ka bërë pagesën e taksës.

Gjykata, në këtë rast nuk gjeti se ekzistojnë konditat për lirimin e paditëses nga pagesa e taksës gjyqësore, andaj konform nenit 253 par.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1414/23, me datë 20.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.